



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale

Mbledhja nr. 90

Ndërtesa e Kuvendit, salla N - 10

Prishtinë, më 5 shkurt 2014, në orën 11:00

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR SHËNDETËSI, PUNË
DHE MIRËQENIE SOCIALE

Në mbledhje morën pjesë: Fikrim Damka, Time Kadrijaj, Sasha Gjokiq, Salihe Mustafa, Nazane Breca, Gëzim Kelmendi dhe Bahri Thaçi.

Mungoi : Flora Brovina .

Të pranishëm: Shaip Muja – deputet , Shpresa Haxhijaj, koordinatore e Komisionit dhe Muhamet Bytyçi – zyrtar i fushës .

Mbledhjen e kryesoi, Fikrim Damka, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës**
- 2. Shqyrtimi i Projektligjit për produkte medicinale dhe pajisje medicinale**
- 3. Të ndryshme**

***Kryesuesi** konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.*

1. Miratimi i rendit të ditës;

Rendi i ditës u miratua pa asnjë ndryshim.

2. Shqyrtimi i Projektligjit për produkte medicinale dhe pajisje medicinale

Fikrim Damka- Tha se grupi punues i ka përfunduar amendamentet në këtë projektligj dhe në konsultim edhe me përfaqësues të Agjencionit për Produkteve dhe Pajisjeve Medicinale dhe Agjencionit të Ushqimit dhe Veterinës kemi vendosur që në amendamente të përfshihet edhe një nen për produktet veterinare.

Deputeti Shaip Muja ka parashtruar një kërkesë që Agjencioni për Produkteve dhe Pajisjeve Medicinale të kaloj në kompetencë të Zyrës së Kryeministrit . Ky nuk është një amendament për të cilin Komisioni duhet të deklarohej , është një propozim që mund ta diskutojmë . Hap diskutimin .

Sasha Dgjokiq – Tha se ndoshta duhet të shikojmë që në praktik si funksionojnë agjencitë ekzekutive, a janë në kuadër të Zyrës së Kryeministrit apo në Ministri.

Fikrim Damka – Tha se gjithashtu me kërkesë të deputetit Shaip Muja , dhe pas konsultimeve të kryeshefit të AKPM – së me Ministrin e Shëndetësisë, kanë propozuar që Inspektorati farmaceutik të kaloj në AKPM .

Time Kadrijaj – Tha se më praktike është që Inspektorati të jetë pjesë e AKPMS- së.

Faton Topalli – U pajtua me propozimin që Inspektorati Farmaceutik të jetë në AKPM.

Nazane Breca – Tha se Inspektorati deri tani ka qenë në kuadër të AKPM por nuk ka qenë shumë funksionale , pra për ne paraqet një dilemë , por prapë se prapë , nëse kryeshefi i AKPM – së, thotë që është më funksionale që Inspektorati të jetë në AKPM , pajtohem.

Salihe Mustafa – U pajtua që të Inspektorati të jetë brenda AKPM – së sipas propozimit të deputetit Shaip Muja.

Bahri Thaçi – Tha se edhe ne kemi pas dilemë se a mundet Inspektorati të funksionoj në Ministri, por pasi kemi edhe propozimin e tyre , atëherë pajtohem që Inspektorati të jetë brenda AKPM së , sepse kohët e fundit me ndërrimin e kryeshefit, inspektorati po funksionon mjaft mirë brenda AKPM së.

Fikrim Damka – Tha se sa i përket nenit 4 , si komision mendojmë se duhet të jetë si në Projektligj , por po ja kaloj fjalën deputetit Shaip Muja që ta arsyetoj propozimin e tij për ndryshimin e nenit 4 , që AKPM të jetë në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, e jo në Ministrin e Shëndetësisë .

Shaip Muja – Tha se propozoj që AKPM të jetë organ i pavarur i cili ekzekuton politikat e Ministrisë së Shëndetësisë por që nuk është organ ekzekutiv i Ministrisë së Shëndetësisë . AKPM duhet të jetë agjencion i pavarur që implementon politikat e Ministrisë së shëndetësisë , dhe duhet të jetë në kuadër të Zyrës së Kryeministrit dhe Inspektorati Farmaceutik të jetë në

kuadër të AKPM së. AKPM nuk është nën organogramin e Ministrisë së Shëndetësisë. Mendoj se nëse mbetet si në nenin 4, ka mangësi juridike.

Sasha Gjokiq – Tha se kisha kërkuar nga deputeti Muja një sqarim se nuk e kam të qartë se çfarë po propozon, a po propozon të krijojmë një agjencion i cili do jetë agjencion i pavarur në kuadër të kryeministrit, nëse po, unë do të jem kundër.

Shaip Muja – Tha se nuk do jetë një agjencion i pavarur si Agjencioni i Privatizimit, sepse nuk e ka atë rol, por një agjencion që do të zbatojë politikat e Ministrisë së Shëndetësisë. Në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, në organogram AKPM dhe Veterinaria janë si zyre që funksionojnë që nga koha e UNMIKUT.

Faton Topalli – Tha se nëse kjo çështje është e paqartë, propozoj që kjo pikë të shtyhet për takimin e ardhshëm dhe të sqarohet se cila është pavarësia e këtij institucioni.

Sasha Gjokiq – Tha se tani e kam të qartë se si do jetë, kjo do të jetë e njëjtë me zyret tjera që janë në kuadër të Zyrës së Kryeministrit.

Shaip Muja – Tha se si Agjencioni i Ushqimi, ashtu edhe AKPM duhet të jenë në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, por ti përgjigjen ministrave përkatës.

Bahri Thaçi – Për ne nuk është me rëndësi se brenda cilit institucion do të funksionoj AKPM ja, por me rëndësi është që ta zbërthejmë se si ata funksionojnë dhe se si është më mirë të funksionojnë, dhe të mos krijojmë një muri të funksionimit në mes të AKPM së dhe Ministrisë së Shëndetësisë. Mendoj se askush nuk ka kapacitete më shumë se Ministria e Shëndetësisë ta mbikëqyrë punën e AKPM së.

Fikrim Damka – Tha se si po shihet nga diskutimet duhet të konsultohemi me AKPM dhe me Ministrin e Shëndetësisë sa i përket nenit 4. Vazhdojmë mbledhjen e radhës.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit

Fikrim Damka